

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Nr. 3888/prot

Koplik më: 29 / 12 / 2025

V E N D I M

Nr 63 datë 24/12/2025

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e tij të datës 24.12.2025, mbështetur në aktin normativ nr 3 datë 15.03.2020 neni 5, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015. "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9 pika 1.7/a, të Ligjit 94/2022 "PËR TITUJT E NDERIT DHE TITUJT VENDORË TË NDERIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" neni 9 pika 1.

VKM Nr.861 datë 10.12.2014 Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë.

VENDOSI

T'i akordojë titullin "Qytetar Nderi "Z. **Jurgen Uldedaj** me motivacionin:

"Për punën, përkushtimin e profesionalizmin e tij në fushën e sportit e në veçanti atij të boksit duke u shpallur Kampion Bote për të na bërë krenarë gjithë malësorët e mbarëshqiptarët kudo që janë duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe e më gjërë".

1. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Brendshme.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 24.12.2025

Vota Pro 25

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 29.12.2025







REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESİ E MADHE

Nr. 388 .prot

Koplik më: 23/12/2025

Këshillit të Bashkisë Malësi e Madhe
Propozim për dhënie titulli “ Qytetarë Nderi “ i Bashkisë Malësi e
Madhe z. Jurgen Uldedaj



Jurgen Uldedaj, i datëlindjes 26 gusht 1997, është një boksier profesionist shqiptar. Ai aktualisht mban titullin kampion bote të peshave të lehta nga tetori i vitit 2025. Karriera e tij si profesionist nisi me më 14 dhjetor 2015. Uldedaj luftoi për titullin e tij të parë profesional më 3 shkurt 2018, kur u përball me Jakub Synek për titullin vakant të peshave të lehta ndërkombëtare gjermane. Uldedaj fitoi ndeshjen e dhjetë raundeve të karrierës së tij me vendim unanim.



Më 15 dhjetor 2018, në Parkun Olimpik "Feti Borova" në Tiranë, Shqipëri, që ishte ndeshja e tij e parë në Shqipëri. Ai u përball me boksierin Dode Tahiri Arganaraz për titullin vakant të WBO Youth në peshën krúizer, ku Ul dedaj e fitoi titullin me vendim unaním të tre gjyqtarëve.

Më 11 maj 2019, u ndesh me Krzysztof Twardowski për titullin e përkohshëm WBC Youth, ku u shpall fitues me vendim unaním të tre gjyqtarëve.

Më 22 gusht 2020, pas një mungese 13-mujore nga sporti, Ul dedaj u përball me Robert Grguric. Ai e fitoi ndeshjen me nokaut në raundin e dytë.

Jurgen Ul dedaj u përball më pas me Bojan Cestic, më 12 dhjetor 2020 duke u shpallur fitues pasi rivali u tërhoq nga ndeshja në fund të raundit të tretë.

Më 17 korrik 2021 ai u përball me Dmytro Serguta për titullin vakant të peshave të lehta WBC Youth, ku Ul dedaj e fitoi ndeshjen me një nokaut teknik në raundin e shtatë.

Në York Hall në Londër më 10 shkurt 2024, Jurgen fitoi titullin vakant të peshave të lehta mesdhetare IBO me vendim unaním kundër John Franck Mendy

Më 19 korrik 2024, Ul dedaj u përball me Steven Ward për titullin vakant të peshave të lehta IBF International në Motorspace Dubai Investments Park në Dubai, duke fituar me tërheqje të rivalit në raundin e pestë.

Ai e ruajti titullin duke mposhtur Edin Puhalo në raundin e dytë në The Hall në Dübendorf, Zvicër, më 20 dhjetor 2024.

Në The O2 Arena në Londër, Ul dedaj u përball me Rolly Lambert Fogoum për titullin botëror vakant të peshave të lehta IBO më 25 tetor 2025. Ai u shpall kampion bote me vendim unaním të gjyqtarëve, duke u shpallur kampion bote në boks.

Në total, Jurgen Ul dedaj ka zhvilluar 22 ndeshje në boksín profesioníst, ku ka marrë 21 fitore, 8 prej të cilave me KO dhe vetëm një humbje.

Jurgeni rrjedh nga familja e njohur Ul dedaj nga Jerani, Bajzë, Malësi e Madhe, nipi i Tom Zef Ul dedaj. Jurgen Ul dedaj ka ngritur në majën e boksit botëror flamurin kuqezí, falë punës, përkushtimit dhe sakrificës në sport, duke qenë edhe një përfaqësues i denjë i brezit të ri, shembull frymëzimi për të rinjtë. Në çdo ndeshje, ai ka shprehur krenarinë e të qënurit shqiptar, duke përfaqësuar me dinjitet edhe vlerat më të mira të origjinës së tij familjare, Malësinë e Madhe.

Për gjitha sa thamë më lartë i propozohet Këshillit Bashkiak Malësi e Madhe ti jepet titulli " Qytetarë Nderi " i Bashkisë Malësi e Madhe me

motivacion:

"Për punën, përkushtimin e profesionalizmin e tij në fushën e sportit e në veçanti atij të boksit duke u shpallur Kampion Bote për të na bërë krenarë gjithë malësorët e mbarëshqiptarët kudo që janë duke lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe e më gjërë".

KRYETAR BASHKIE

TONIN MARINAJ

